



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 526, datë 10.11.2021**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM  
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtares {...} për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

---

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

### 1.A. NJOHURITË LIGJORE

#### 1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara, është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsytet e zgjidhjes së çështjes (shih dokumentin 1, si dhe dosjet 2, 3, 4 e 5). Në çështjet penale, i kushton rendësi të gjithë elementeve të veprës penale (shih dokumentet 2 e 3, si dhe dosjen 1), si dhe ndalet me kujdes tek dënimi penal dhe alternativat e tij (shih dosjen 1). Ka njohuri të procedurave të gjykimit në raport me llojin e çështjeve gjyqësore penale apo civile që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit gjer tek arsytimi i vendimit gjyqësor. Natyra e çështjeve që ajo ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme dhe tregon gjerësinë e njohurive të saj të përfituara përmes përvojës në punë në një gjykatë të paorganizuar në seksione. 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara tregojnë njohuri të saj për mënyrat e fitimit të pronësisë (shih dokumentin 1), çështjet familjare (shih dosjet 2 e 4), mosmarrëveshjet e punës (shih dosjen 3), përgjegjësinë penale për veprën penale të drejtimin të automjetit në gjendje të parregullt, të parashikuar nga neni 291 i K.Penal (shih dosjen 1), procedurat e njohjes së vendimit penal të huaj (shih dokumentin 2) dhe procedurat për rivendosjen në afat të ankimit (shih dokumentin 3)”.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjykimit. Evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje dhe në mënyrë të integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Në vendimet civile, evidentohet se gjyqtarja tregon kujdesin e duhur që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile, të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.<sup>1</sup>

Gjithashtu, edhe në vendimet penale, referuar natyrës së gjykimit (*gjykim penal themeli apo kërkesa penale*), evidentohet se gjyqtarja tregon kujdesin e duhur, duke përshkruar faktin penal sikurse ai ka rezultuar i provuar në gjykim, nga tërësia e provave të administruara. Rrethanat e faktit vijnë menjëherë pas prezantimit të çështjes dhe arsytimit lidhur me juridiksionin, kompetencën apo kërkesat procedurale të palëve, sikurse është rasti i pranimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, si dhe në ndonjë rast, pasi janë parashtruar pretendimet e palëve ndërgjyqëse.<sup>2</sup>

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, e cila orienton më pas ndërtimin e një strukture specifike në organizimin e arsytimit të vendimeve, në çështje me natyra të ndryshme (penale themeli, kërkesa penale, çështje familjare, çështje civile të përgjithshme dhe çështje marrëdhënie pune).

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale.

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu edhe me identifikimin e ligjit të zbatueshëm procedural dhe material në zgjidhjen e çështjes. Në këtë drejtim, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet aftësia e gjyqtarës për të përcaktuar qartë dhe saktë ligjin e zbatueshëm, duke evidentuar dispozitat e ligjit procedural dhe ligjit material në gjithë përmbajtjen e vendimit, në vendin e duhur dhe në shërbim të analizës ligjore të çështjes.

---

<sup>1</sup> Vendimi nr. 22-2015-33 (21), datë 27.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

<sup>2</sup> Vendimi nr. 53-2016-2392 (173), datë 10.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e problemeve dhe situatave procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (*marrëdhënie pune, padi pronësie, padi detyrimi, zgjidhje martese*), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, të Kodit të Punës, të Kodit të Familjes, por edhe ligjeve organike përkatëse, nga ku evidentohet më konkretisht se:

- a) Në vendimin gjyqësor me objekt padinë reale të pushimit të cenimit të pronësisë (*padia mohuese*),<sup>3</sup> gjyqtarja fillimisht identifikon normën relevante për zgjidhjen e çështjes (*nenin 302 të K.Civil, të cilin e identifikon përpara se të bëjë analizën ligjore, si dhe nenet 264, 265, 277 dhe 279 të K.Civil, të cilët identifikohen në pjesën e analizës ligjore*), por njëkohësisht edhe dispozitat e tjera materiale civile që kanë lidhje me normën kryesore, si ligjet e posaçëm (*ligji nr. 8561, datë 10.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*) në funksion të provueshmërisë së veprimeve të paligjshme të palës së paditur;
- b) Në vendimin gjyqësor me objekt padinë për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me titull dhe kundërpadinë me objekt padinë reale të kërimit të sendit (*padia e rivendikimit*),<sup>4</sup> gjyqtarja, duke marrë fillimisht në analizë padinë, identifikon dispozitën ligjore relevante (*nenin 168 të K.Civil*), si dhe dispozitat e tjera materiale civile në funksion të konkludimit në lidhje me kushtin e ekzistencës së veprimit juridik (*ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, ligjin nr.7698, datë 15.04.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”*), të cilat identifikohen dhe analizohen edhe në rastin e shqyrtimit të bazueshmërisë së kundërpadisë. Në analizë të bazueshmërisë së kundërpadisë merret neni 296 i K.Civil (*padia për kërkimin e sendit*) dhe në funksion të pasojave që sjell vendimi gjyqësor i dhënë, gjyqtarja identifikon nenin 196 të K.Civil dhe ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”;
- c) Në vendimin gjyqësor me objekt marrëdhënie pune,<sup>5</sup> gjyqtarja identifikon dispozitat materiale relevante (*nenet 140, 141, 143, 144, 145, 153, 155 të K.Punës*), me qëllim identifikimin e natyrës juridike të marrëdhënies së punës në rastin konkret, e më tej, për të konkluduar në lidhje me kërkimet e veçanta të parashtruara nga pala paditëse;
- d) Në vendimin gjyqësor me objekt padi detyrimi,<sup>6</sup> me qëllim përcaktimin e natyrës së kontratës në fjalë, si dhe të konkludimit në lidhje me kërkimet në padi, gjyqtarja identifikon normat ligjore relevante (*nenet 746, 698, 702, 699, 748, 690, 742, 749 të K.Civil*);
- e) Në vendimet gjyqësore me objekt zgjidhje martese dhe rregullimin e pasojave që vijnë prej saj, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale relevante (*nenet 129, 132, 133, 134, 146/1, 155, 157 të K.Familjes*) etj.

(ii) Në vendimet penale të analizuar, gjyqtarja identifikon dispozitën materiale penale të sanksionuar në Kodin Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik

<sup>3</sup> Vendimi nr. 22-2015-33 (21), datë 27.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

<sup>4</sup> Vendimi nr. 18, datë 24.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

<sup>5</sup> Vendimi nr. 22-2014-239 (161), datë 05.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

<sup>6</sup> Vendimi nr. 44, datë 08.04.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, në rastet kur kemi të bëjmë me vendime themeli, ndërsa në dy raste të tjera, ku kemi të bëjmë me kërkesa penale, gjykata identifikon dispozitat procedurale penale të sanksionuara në Kodin e Procedurës Penale, në funksion të analizimit të çështjes dhe konkludimit në lidhje me bazueshmërinë e saj në prova dhe në ligj, nga ku evidentohet më konkretisht se: Në vendimet penale të themelit, gjyqtarja identifikon nenin 291 të K.Penal në lidhje me akuzën “Drejtimit i mjetit në mënyrë të parregullt”. Referohet dispozita e Kodit Penal, e pjesës së posaçme, në lidhje me veprën penale për të cilën procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me individualizimin e dënimit dhe aplikimin e alternativave të dënimit (*nenet 47 dhe 59 të K.Penal*).

Në kërkesat penale, në rastin e njohjes së një vendimi penal të huaj, gjyqtarja identifikon dispozitën procedurale relevante (*nenin 514 të K.Pr.Penale*) si dhe identifikimin e dispozitave të tjera ligjore (*ligjin nr. 10 193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar*). Në kërkesën penale me objekt “rivendosje në afat të së drejtës së ankimit”, gjyqtarja identifikon dispozitat përkatëse relevante (*nenet 147, 148, 417 dhe 462 të K.Penal*).

Sa i përket ligjit procedural civil, gjyqtarja ka referuar dhe cituar, si pjesë e arsytimit të vendimit: *nenet 35, 36, 41, 42, 43, 45, 50, 51, 52 dhe 59 të K.Pr.Civile*, lidhur me përcaktimin e juridiksionit gjyqësor civil, si dhe kompetencën lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e çështjes civile, familjare ose marrëdhënie pune; *nenin 185 të K.Pr.Civile*, lidhur me ndryshimin e objektit të padisë;<sup>7</sup> *nenet 189 dhe 190 të K.Pr.Civile*, lidhur me ndërhyrjen kryesore;<sup>8</sup> *nenet 55, 160 dhe 161 të K.Pr.Civile*, në lidhje me pranimin për shqyrtim të kundërpadisë dhe bashkimin e saj në gjykim me padinë;<sup>9</sup> *nenin 35 të K.Pr.Civile*, lidhur me përbërjen e trupit gjykues; *nenet 6, 14 dhe 28 të K.Pr.Civile*, lidhur me përcaktimin e kufijve të shqyrtimit të çështjes nga gjykata;<sup>10</sup> *nenet 106 dhe 110 të K.Pr.Civile*, lidhur me shpenzimet gjyqësore,<sup>11</sup> etj.

Sa i përket ligjit procedural penal, gjyqtarja ka referuar dhe cituar, si pjesë e arsytimit të vendimeve: *nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale*, në lidhje me vlerësimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar; *nenet 69, 74 dhe 76*, sa i përket vlerësimin të çështjes së juridiksionit dhe kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës për gjykimin e çështjes penale; *nenet 393/1 dhe 485 të K.Pr.Penale*, sa i përket disponimit për shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në kërkesat penale, ku për zgjidhjen në themel të çështjes, referimi bëhet në ligjin procedural penal, në rastin e njohjes së një vendimi penal të huaj, gjyqtarja identifikon dispozitën procedurale relevante (*nenin 514 të K.Pr.Penale*), si dhe identifikimin e dispozitave të tjera ligjore (*ligjin nr. 10 193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, i ndryshuar*). Ndërkohë, në kërkesën penale me objekt “rivendosje në afat të së drejtës së ankimit”, gjyqtarja identifikon dispozitat përkatëse relevante (*nenet 147, 148, 417 dhe 462 të K.Pr.Penale*).

<sup>7</sup> Vendimi nr. 22-2015-33 (21), datë 27.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

<sup>8</sup> Vendimi nr. 18, datë 24.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Vendimi nr. 18, datë 24.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; Vendimi nr. 44, datë 08.04.2014 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; Vendimi nr. 22-2015-33 (21), datë 27.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

<sup>11</sup> Vendimi nr. 22-2015-33 (21), datë 27.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet e analizuara nuk rezulton të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve.

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

### **1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit Omela {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, ndonëse në tekstin e vendimeve përfundimtare i përdor në raste të rralla. Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit ajo përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (shih dokumentet 2 dhe 3, si dhe dosjen 1) nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentin 1) apo nga jurisprudenca e GJEDNJ-së (shih dokumentet 2 dhe 3)*”.

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*asaj materiale - civile apo penale, si dhe procedurale penale në rastin e kërkesave penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk është i pashoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave

materiale/procedurale<sup>12</sup> bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:**

(i) *Në vendimet civile*, përgjithësisht, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se:

- Në funksion të arsytimit ligjor, gjyqtarja interpreton dispozitën materiale që disiplinon institutin e fitimit të pronësisë në mënyrë origjinale, me parashkrim fitues me titull (*neni 168 i K.Civil*), në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për të fituar pronën nëpërmjet kësaj mënyre origjinale të fitimit të pronësisë. Në të njëjtin vendim, gjyqtarja interpreton nenin 296 të K.Civil (*padinë e rivendikimit*), me qëllim konkludimin nëse kërkesa e parashtruar në kundërpadi për lirim dhe dorëzim sendi, është e bazuar ose jo.<sup>13</sup>
- Në një rast tjetër (*padia mohuese*), gjyqtarja interpreton dispozitën materiale që rregullon këtë padi reale (*neni 302 i K.Civil*), si dhe dispozitat ligjore në lidhje me servitutin e kalimit (*nenet 193/b, 264, 265, 277 dhe 279 të K.Civil*), në funksion të analizës së posedimit të ligjshëm/paligjshëm nga ana e palës së paditur.<sup>14</sup>
- Për të analizuar shkaqet për zgjidhjen e martesës (*në çështjet familjare*), gjyqtarja interpreton nenet 129 dhe 132 të K.Familjes, interpreton nenin 146/1 të K.Familjes në lidhje me ndryshimin e mbiemrit pas zgjidhjes së martesës, si dhe interpreton nenin 6 të K. Familjes në lidhje me të drejtat e të miturit në proces.<sup>15</sup>
- Referuar interpretimit literal të bërë dispozitës materiale (*neni 143 të K.Punës*), dhe rrethanave të faktit, gjyqtarja konkludon se zgjidhja e kontratës së punës është kryer në mënyrë të menjëhershme, pa respektuar afatin e njoftimit, e për pasojë, në lidhje me këtë mënyrë përfundimi, referenca ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes orientohet drejt normave materiale, neneve 153 dhe 155 të K.Punës, për të përcaktuar nëse shkaqet e zgjidhjes e justifikojnë këtë mënyrë përfundimi të marrëdhënies së punës me paditësin. Gjyqtarja interpreton dispozitën përkatëse (*nenin 153 të K.Punës*) duke analizuar në përputhje me faktet, kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, që të legjitimojnë punëdhënësin që të zgjidhë në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me punëmarrësin. Më tej, gjyqtarja analizon nenin 144 të K.Punës, për të verifikuar nëse nga ana e punëdhënësit është respektuar procedura e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, si dhe interpreton nenin 145/1 të K.Punës, me qëllim konkludimin nëse plotësohen kushtet në mënyrë kumulative për të përfituar punëmarrësi shpërblimin për vjetërsi në punë.<sup>16</sup>

<sup>12</sup> Kjo në rastin e kërkesave penale. Shih vendimin nr. 53-2016-2392 (173), datë 10.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe vendimin nr. 53-2016-2967 (243), datë 17.11.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

<sup>13</sup> Vendimi nr. 18, datë 24.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

<sup>14</sup> Vendimi nr. 22-2015-33 (21), datë 27.01.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

<sup>15</sup> Vendimi nr. 402-12-2016, datë 22.07.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; Vendimi nr. 22-2014-274 (179), datë 01.12.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; Vendimi nr. 22-2015-146 (93), datë 29.04.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

<sup>16</sup> Vendimi nr. 22-2014-239 (161), datë 05.11.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

*(ii) Në vendimet penale:* Gjyqtarja referon, citon dhe interpreton nenin 291 të Kodit Penal në drejtim të vlerësimit lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal, si dhe analizës së elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën procedohet i pandehuri. Në funksion të analizës së dispozitës materiale (neni 291), duke qenë se kjo është një dispozitë *blankete*, gjyqtarja referon dhe interpreton nenin 115 të ligjit nr.8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Në këto vendime interpretohen gjithashtu dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, sa i përket përcaktimit të qëllimit të dënimit penal, kushteve dhe kriterëve ligjore të individualizimit të dënimit, si dhe aplikimit të masave alternative të dënimit me burgim.

Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale, evidentohet se gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normave procedurale, kryesisht në lidhje me:

*Në vendimet penale të themelit:*

- interpreton nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale, në lidhje me kushtet procedurale të pranueshmërisë së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, duke u shoqëruar ky interpretim me referimin e praktikës gjyqësore, konkretisht, vendimin nr.2, datë 29.01.2003, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- interpreton nenin 389 të K.Pr.Penale, në lidhje me disponimin që duhet të bëjë gjykata, në rastet kur i pandehuri i hetuar ka qenë me masë sigurimi.

*Në kërkesat penale:*

- interpreton nenin 147 të K.Pr.Penale, në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të vendimit penal;
- interpreton nenin 514 të K.Pr.Penale, lidhur me pranueshmërinë e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria për njohjen e një vendimi penal të huaj, si dhe institutin e njohjes së vendimeve penale të huaja nga gjykatat shqiptare.

*Në vendimet civile:*

- interpreton ndryshimin e objektit të padisë, në referim të nenit 185 të K.Pr.Civile, duke argumentuar se nuk ka ndryshuar shkak i ligjor i padisë.
- interpreton nenet 160 dhe 161 të K.Pr.Civile, lidhur me pranueshmërinë e kërkesës për shqyrtimin e kundërpadisë në gjykim;<sup>17</sup>
- interpreton nenin 55 të K.Pr.Civile, lidhur me bashkimin e çështjeve në gjykim;<sup>18</sup>
- interpreton nenet 189 dhe 190 të K.Pr.Civile, lidhur me ndërhyrjen kryesore;<sup>19</sup>
- interpreton nenin 35 të K.Pr.Civile, lidhur me përbërjen e trupit gjykues;
- interpreton nenin 6, 14 dhe 28 të K.Pr.Civile, lidhur me përcaktimin e kufijve të shqyrtimit të çështjes nga gjykata;
- interpreton nenin 32/c të K.Pr.Civile, lidhur me pranueshmërinë e padisë për njohjen e pavërtetësisë së shënimeve;<sup>20</sup>

<sup>17</sup> Vendimi nr. 18, datë 24.02.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Po aty.

<sup>20</sup> Vendimi nr. 12-2016-460 (164), datë 30.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.



- interpreton nenin 609 të K.Pr.Civile, lidhur me pranueshmërinë e padisë për deklarimin e pavlefshëm të titullit ekzekutiv vendim gjyqësor.<sup>21</sup>

**- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës**

Nga tërësia e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtarja në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në disa raste duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve rezulton se gjyqtarja njih dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimin e ligjshmërisë*, ku gjyqtarja edhe pse nuk e citon si të tillë, analizon domosdoshmërinë e ekzistencës dhe provueshmërisë së të katër elementëve të figurës së veprës penale, si kusht për ekzistencën e saj dhe për pasojë, për përgjegjësinë penale të të pandehurit për faktin penal që i atribuohet;
- Parimet e përgjithshme në caktimin dhe individualizimin e dënimit, *si parimi i barazisë para ligjit, parimi i drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe parimi i humanizmit*. Këto parime, pavarësisht se nuk citohen shprehimisht, rezultojnë të jenë zbatuar nga gjyqtarja në të gjitha vendimet penale të themelit, ku ajo interpreton paraprakisht qëllimin e dënimit penal dhe më pas vijon me përcaktimin dhe individualizimin e dënimit, duke iu referuar kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 47 të Kodit Penal, prezencën dhe ndikimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese;
- *Parimin e procesit të rregullt ligjor*, aspekte të të cilit rezultojnë nga konteksti i vendimeve të analizuara, në të cilat rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi elementëve të tillë si: disponibiliteti i padisë nga ana e paditësit, barra e provës, kontradiktoriteti, e drejta e mbrojtjes (në procesin penal) etj.

**- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.**

Në disa nga vendimet e analizuara rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ (referuar edhe si Gjykata e Strasburgut)*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Rezulton se nga ana e gjyqtarës është cituar dhe zbatuar në drejtim të vlerësimit për pranimin e kërkesës për të proceduar më gjykim të shkurtuar, vendimi unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- Në vendimin civil të themelit, ku gjykata në të njëjtin gjykim ka gjykuar edhe kundërpadinë e paraqitur nga pala e paditur, si dhe ndërhyrjen kryesore, gjyqtarja, në mbështetje të analizës që i bën ligjit “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe ligjit

---

<sup>21</sup> Vendimi nr. 22-2016-82 (38), datë 23.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

“Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, e mbështet arsyetimin e saj në vendimin unifikues nr. 9, datë 16.01.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Lidhur me bazueshmërinë në prova dhe në ligj të kundërpadisë, gjyqtarja ka çmuar të theksojë praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimin unifikues nr. 5, datë 30.10.2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në lidhje me fuqinë ligjore që ka vendimi i Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), gjyqtarja mbështetet arsyetimin e saj në vendimet nr.43, datë 06.10.2011 dhe nr.27, datë 26.05.2010, të Gjykatës Kushtetuese. Po në këtë vendim, lidhur me të drejtën e ish-pronarit (trashëgimtarëve të tij) në aplikimin të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave të ish-pronarëve”, gjykata thekson jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, konkretisht në çështjen *Maria Atanasiu dhe të tjerë kundër Rumanisë*.

- Në vendimin gjyqësor me kërkesë për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit penal, gjyqtarja, në funksion të konstatimit se është kompetente për shqyrtimin e kërkesës objekt gjykimi, si gjykata e rrethit gjyqësor që ka gjykuar çështjen, e ka mbështetur analizën e saj juridike në vendimin nr. 31/2012 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe në vendimet unifikues nr. 1, datë 10.03.2014 dhe 18.06.2013 e 19.06.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, në analizë të së drejtës që ka mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët për të ushtruar ankim, gjyqtarja i është referuar vendimit unifikues nr. 1, datë 10.03.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Po në këtë vendim, në lidhje me të drejtën e mbrojtjes, të garantuar nga neni 6 (1) dhe 6 (3) (c) i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, gjyqtarja citon praktikën e konsoliduar të Strasburgut, në çështjet *Balliu kundër Shqipërisë*, *Imbrioscia kundër Zvicrës* etj.
- Në çështjen penale me objekt “njohjen e vendimit penal të huaj”, gjyqtarja, në funksion të arsyetimit për të drejtën e të pandehurit për t’u ndihmuar nga një mbrojtës në procesin penal, ka referuar në praktikën e GJEDNJ, duke cituar çështjet *Krombach kundër Francës*, *Karatas dhe Sari kundër Francës*, *Goth kundër Francës*, *Goddi kundër Italisë* etj.

## **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën e Gjykatës Kushtetuese, praktikën e konsoliduar të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.B. ARSYETIMI LIGJOR**

### **1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj, në përgjithësi janë të qarta dhe të kuptueshme. Në të gjitha rastet respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe gjithmonë janë përdorur edhe karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten ndonjëherë të gjata, por janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Përdor të gjitha shkronjat e alfabetit shqip, në mënyrë të veçantë konstatohet se në vendimet gjyqësore përdoren shkronjat shqipe (*ë dhe ç*).

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Por, evidentohet se jo rrallë, gjyqtarja përdor fjali të gjata, me qëllim që të mos ndërpresë mendimin. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

#### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil (shih dhe dosjen 1, si dhe dokumentet 2, 3, 4 dhe 5) apo kërkesat e legjislacionit procedural penal (shih dokumentet 2 e 3, si dhe dosjen 1)*”.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimit, ku gjyqtarja i referohet prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit. Konstatohet se vendimet civile përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile:

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënave lidhur me gjykatën, koha dhe vendi i zhvillimit të gjykimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

*Në pjesën përshkruese-arsyetuese* gjejnë pasqyrim në mënyrë të strukturuar: procedura e ndjekur (e cila përgjithësisht nuk titullohet nga ana e gjyqtarës); parashtrimi në mënyrë të përmbledhur i pretendimeve të palëve; rrethanat e fakteve të çështjes, siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi; për të vijuar më tej me analizën ligjore, ku gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionet e saj.

*Pjesa e dispozitivit* është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me objektin e padisë, si dhe elementët e tjerë të vendimit lidhur me shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, etj. Gjyqtarja ndjek një strukturë pothuajse të njëjtë

në paraqitjen e vendimeve përfundimtare, e cila është karakteristikë e qëndrueshme e gjyqtarës, çka i bën vendimet e saj tepër të qarta dhe të kuptueshme.

Po kështu, konstatohet se vendimet penale përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale:

*Pjesa hyrëse* përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohën e zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë, nenin përkatës të Kodit Penal, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

*Pjesa përshkuese-arsyetuese* e vendimeve është e ndarë në disa pjesë, ku pjesa e parë përgjithësisht nuk titullohet formalisht e në disa raste titullohet “Procedura gjyqësore/Aspekte procedurale”, ndërkohë që pjesët në vijim listohen formalisht si: “Rrethanat e faktit/çështjes”, “Analiza juridike” dhe “Individualizimi i dënimit penale”, ku në mënyrë të detajuar analizon:

(i) Pjesa e parë ka të bëjë kryesisht me elementë proceduralë, në të cilën gjyqtarja përshkruan në mënyrë kronologjike ecurinë procedurale çështjes, duke filluar me paraqitjen e çështjes në gjykatë, shqyrtimin kryesisht të përcaktimit të kompetencës lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes, si dhe disponimin e gjykatës lidhur me kërkesën paraprake të të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar, ose pretendimet e palëve.

(ii) Rrethanat e fakteve të çështjes, gjyqtarja përshkruan faktin penal objekt akuze, në përputhje dhe të integruar me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në kërkesat penale, gjyqtarja përshkruan faktet që lidhen me vendimin penal dhënë nga shteti i huaj, ose me vendimin penal të dhënë dhe ankimin e ushtruar nga mbrojtësja e zgjedhur nga familjarët.

(iii) Vlerësimi i gjykatës, ku gjyqtarja bën analizën ligjore mbi provat dhe cilësimin juridik të veprës penale, si dhe caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, ku në fund evidentohen edhe disponimet lidhur me masën e sigurimit me të cilën është hetuar i pandehuri dhe disponimi për sendet e sekuestruara. Në kërkesat penale, gjyqtarja bën analizë të detajuar dhe të ndërthurur të ligjit të zbatueshëm, me faktet që kanë rezultuar të provuara në gjykim, si dhe konkludimet në lidhje me bazueshmërinë në ligj dhe në prova të kërkesave të marra në shqyrtim.

*Dispozitivi i vendimeve* është i plotë (me përjashtim të një rasti ku gjyqtarja ka harruar të shprehet në dispozitiv në lidhje me zbatimin e nenit 403 të K.Penal),<sup>22</sup> i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të qartë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurit, akuzën përkatëse, nenin respektiv të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar, disponimin e plotë për shpenzimet procedurale, si dhe të drejtën e ankimit. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e plotë, e lexueshme dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me të gjithë elementët e disponimit në vendimin përfundimtar, në funksion të qartësisë së tij për palët dhe lexuesin, si dhe të ekzekutimit të tij.

---

<sup>22</sup> Vendimi nr. 22-2015-409 (49), datë 03.12.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

## KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### 1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rendësi analizës së normës ligjore, e cila kur është rasti plotësohet edhe me pjesë nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese apo GJEDNJ-së (shih 3 dokumentet dhe dosjen 1). Një tipar i mirë i punës së saj është fokusimi i arsyetimit të vendimit tek thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, duke shmangur fjalitë e përgjithshme apo arsyetim të tepërt mbi çështje të konsoliduar nga praktika dhe doktrina”.

#### - Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi,<sup>23</sup> në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi

<sup>23</sup> Vetëm në një vendim gjyqësor civil, konkretisht në vendimin nr. 01, datë 14.01.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, me objekt: “Ndreqje e gabimit në vendimin nr. 306, datë 27.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet”, pasur parasysh vetë natyrën e kërkesës civile të paraqitur, gjyqtarja nuk rezulton të ketë bërë analizë juridike të ligjit të aplikueshëm procedural civil pasur parasysh faktet e provuara në gjykim.

i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal.

Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim, për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar edhe analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo asaj penale, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak-pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore të faktit penal, duke qenë se rëndësia e lidhjes shkakësore qëndron në kuptimin ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale.

### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, si në çështjet civile, ashtu edhe në çështjet penale.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

### **Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarës”**

<b>KRITERI</b>	
<b>AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARËS</b>	
<b>Niveli i vlerësimit</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	100

## **2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARËS**

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.*

## **2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË**

### **2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} ka qenë e ndryshme, në intervale kohore nga 24 ditë (shih dosjen 1) deri në 5 muaj e 13 ditë (shih dosjen 2). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen me të lartë të gjykimit ka qenë çështje familjare themeli, e shqyrtuar në 6 seanca, me palë por me një kërkim, ku në përfundim është disponuar me vendim pranimit i padisë, vendimi i cili nuk është ankimuar. Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 15 ditë (shih dosjen nr. 3), 1 muaj e 20 ditë (shih dosjen nr.5) dhe 4 muaj e 7 ditë (shih dosjen 4)”*.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës {...}, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu, edhe për çështjet civile, në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për asnjë prej tyre nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.



Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër në të cilat nuk parashikohet ndonjë afat ligjor për përfundimin e tyre aftësia e gjyqtarës në lidhje me këtë tregues, pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, gjyqtarja vlerësohet “0-10%”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 2 vendimeve<sup>24</sup> të përzgjedhura nga gjyqtarja, si dhe të dhënave të analizuara në Aktin e Vlerësimit të Përshpejtuar për vitin 2014.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Në 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar se në 3 prej tyre është respektuar standardi i procesit të rregullt ligjor (shih dosjet 1, 3 dhe 5). Megjithatë, në 2 raste që është tejkalar afati standard, shkaku lidhet me njoftimin me shpallje të të paditurës (shih dosjen 2) dhe me faktin se çështja është shqyrtuar nga gjyqtarja me delegim për llogari të një gjykate tjetër (shih dosjen 4)”.

Në aktin e vlerësimit të përshpejtuar për periudhën e vlerësimit janar-dhjetor 2014, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Në vitin 2014, gjyqtarja {...} ka gjykuar gjithsej 21 çështje gjyqësore (5 çështje civile me palë kundërshtare, 9 çështje civile pa palë kundërshtare. 3 çështje civile të veçanta, 1 çështje penale

<sup>24</sup> Vendimi nr. 18, datë 24.02.2014 i përzgjedhur nga gjyqtarja nuk ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes, në këto kushte nuk mund të përcaktohet kohëzgjatja e gjykimit të kësaj çështje.

*për kundravajtje dhe 3 çështje administrativo-penale) jashtë afateve standard të Sistemit të Vlerësimit. Këto 21 çështje të gjykuara përtej afateve në raport me 144 çështjet gjyqësore të gjykuara gjithsej prej saj zënë masën 14.58% për periudhën e vlerësimit. Nga vëzhgimi i 2 çështjeve të zvarritura të për zgjedhura me short evidentohen si shkaqe zvarritjeje: (i) marrja e provave; (ii) thirrja dhe njoftimi i palëve; (iii) pushimet vjetore. Rrjedhimisht për aspektin kohor, gjyqtarja {...} klasifikohet Mirë”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur brenda standardeve minimale kohore, sipas Vendimit nr.261/2 të KLD, dhe duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve rezulton:

#### Çështje civile:

- Dosja 3 - (është caktuar me short në datën 16.09.2014 dhe ka përfunduar në datën 05.11.2014) Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 15 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 6 - (është caktuar me short në datën 03.01.2014 dhe ka përfunduar në datën 08.04.2014) Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 5 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 9 - (është caktuar me short në datën 21.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 27.01.2015) Gjykimi ka zgjatur 6 muaj e 6 ditë, tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile (tejkallim vetëm me 6 ditë);
- Dosja 10 - (është caktuar me short në datën 06.03.2016 dhe ka përfunduar në datën 23.03.2016) Gjykimi ka zgjatur 17 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 11 - (është caktuar me short në datën 22.02.2016 dhe ka përfunduar në datën 30.03.2016) Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 8 ditë, brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile.

#### Çështje penale:

- Dosja 1 - (është caktuar me short në datën 09.11.2015 dhe ka përfunduar në datën 03.12.2015) Gjykimi ka zgjatur 24 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 7 - (është caktuar me short në datën 20.01.2014 dhe ka përfunduar në datën 05.05.2014) Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 15 ditë, brenda afatit 9 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).

#### Çështje familjare:

- Dosja 2 - (është caktuar në datën 18.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 01.12.2014) Gjykimi ka zgjatur 5 muaj e 13 ditë, tej afatit 4 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet familjare;
- Dosja 4 - (është caktuar me short në datën 16.09.2014 dhe ka përfunduar në datën 05.11.2014) Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 15 ditë, brenda afatit 4 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet familjare;
- Dosja 8 - (është caktuar me short në datën 01.12.2014 dhe ka përfunduar në datën 29.04.2015) Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 28 ditë, tej afatit 4 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet familjare.

### Kërkesa penale:

- Vendimi 2 - (është regjistruar në datën 30.06.2016 dhe ka përfunduar në datën 10.10.2016) Gjykimi ka zgatur 3 muaj e 10 ditë, tej afatit 2 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet e çështjeve të karakterit administrativo-penal;
- Vendimi 3 - (është regjistruar në datën 28.09.2016 dhe ka përfunduar në datën 17.11.2016) Gjykimi ka zgatur 1 muaj e 20 ditë, brenda afatit 2 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet e çështjeve të karakterit administrativo-penal.

### Kërkesa civile:

- Dosja 5 - (është caktuar me short në datën 25.11.2013 dhe ka përfunduar në datën 14.01.2014) Gjykimi ka zgatur 1 muaj e 20 ditë, brenda afatit 2 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet e çështjeve civile pa palë kundërshtare.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga çështjet e analizuarra për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, përfshirë këtu edhe çështjet e analizuarra në raportin e vlerësimit të vitit 2014 (në përlogaritje nuk janë marrë parasysh çështjet e përzgjedhura me short të cilat i përkasin vitit 2014, për shkak se këto çështje përfshihen edhe në raportin e vlerësimit të vitit 2014), rezulton se 24 (njëzetë e katër) çështje ose 15.89% e tyre kanë përfunduar tej afatit standard minimal kohor të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të ish- KLD-së.

Përqindja matematikore prej 15.89% përkon me nivelin e vlerësimit 4 (katër) pikë, por vlerësuesi, veç analizës matematikore, duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Pavarësisht se për 15.89% të çështjeve të shqyrtuara, rezulton tejkalimi i standardit minimal kohor të pranuar, rezulton se kjo nuk është pasojë e mosmenaxhimit efektiv të procesit, por pasojë e ecures procedurale të çështjes. Edhe në raportin e vlerësimit të vitit 2014 lidhur me analizimin e ecures së çështjes konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 2 çështjeve të zvarritura të përzgjedhura me short evidentohen si shkaqe zvarritjeje: (i) marrja e provave; (ii) thirrja dhe njoftimi i palëve; (iii) pushimet vjetore”. Nga ana tjetër, në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 538 çështje, nga të cilat 437 çështje<sup>25</sup> kanë qenë çështje me palë kundërshtare, mesatarisht 146 çështje themeli në vit.<sup>26</sup>

### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuarra, që rezultojnë në masën 15.89%; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit, të cilat, nga dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarës dhe (iii) standardi sasior i punës i cili është më i ulët se ngarkesa minimale e përcaktuar me Vendimin nr.261/2 të KLD, gjyqtarja për këtë tregues vlerësohet në një nivel më të lartë se ai që i përket përqindjes së pikëzimit.

<sup>25</sup> 50 penale; 91 civile; 2 urdhër mbrojtje dhe 24 familjare.

<sup>26</sup> Gjyqtari i shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 çështje, penale (krime dhe kundravajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i standardeve minimale kohore” në kushtet kur përqindja e çështjeve të gjykuara tej standardit minimal është 15.89%, ka ardhur përgjithësisht për shkaqe procedurale që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

## **2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} ka qenë e ndryshme, në intervale kohore nga 24 ditë (shih dosjen 1) deri në 5 muaj e 13 ditë (shih dosjen 2). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit ka qenë çështje familjare themeli, e shqyrtuar në 6 seanca, me palë por me një kërkim, ku në përfundim është disponuar me vendim pranimit i padisë, vendim i cili nuk është ankimuar. Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 1 muaj e 15 ditë (shih dosjen nr. 3), 1 muaj e 20 ditë (shih dosjen nr. 5) dhe 4 muaj e 7 ditë (shih dosjen 4)..... Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezulton se kohëzgjatja e gjykimit për çështjen e parë civile me palë kundërshtare nuk pasqyrohet nga aktet, për çështjen e dytë administrative penale 3 muaj e 10 ditë (shih dokumentin 2), ndërsa për çështjen e tretë kërkesë civile 1 muaj e 20 ditë (shih dokumentin 3). Në këto 2 dokumente me të dhëna të plota, 1 prej tyre është shqyrtuar brenda afatit standard (shih dokumentin 3), ndërsa tjetri është shqyrtuar jashtë afatit standard (shih dokumentin 2)”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës {...}, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve.

Në “Aktin e vlerësimit të përsheptuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, të gjyqtarës {...}, konstatohet se “Në vitin 2014, gjyqtarja {...} ka gjykuar gjithsej 21 çështje gjyqësore (5 çështje civile me palë kundërshtare, 9 çështje civile pa palë kundërshtare. 3 çështje civile të veçanta, 1 çështje penale për kundravajtje dhe 3 çështje administrativo-penale) jashtë afateve standard të Sistemit të Vlerësimit”. Këto të dhëna të referuara në aktin e vlerësimit nuk mund të merren në analizë lidhur me kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, për shkak se përveç konstatimit se janë gjykuar tej afateve të standardeve minimale të gjykimit, nuk referohen të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve.

Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 2 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit.<sup>27</sup>

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (nga 13 çështjet e marra në analizë, nga të cilat 3 çështje familjare, 2 çështje penale themeli, 5 çështje civile themeli, 1 çështje civile pa palë kundërshtare dhe 2 kërkesa administrativo-penale), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 (tre) çështje në kategorinë e çështjeve “Familjare”, rezulton të jetë 146 ditë, rreth 4 muaj e 26 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal për gjykimin e mosmarrëveshjeve familjare.<sup>28</sup>
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështje në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë 64 ditë ose 2 muaj e 4 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve penale krime në Gjykatën e Shkallës së Parë.<sup>29</sup>
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 5 (pesë) çështje në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezulton të jetë 76 ditë, rreth 2 muaj e 16 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.<sup>30</sup>
- (iv) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Kërkesa civile pa palë kundërshtare”, rezulton të jetë 50 ditë, rreth 1 muaj e 20 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile pa palë kundërshtare në Gjykatën e Shkallës së Parë.<sup>31</sup>

<sup>27</sup> Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.

<sup>28</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “d. Gjykimet e mosmarrëveshjeve familjare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj”.

<sup>29</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “ a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm”.

<sup>30</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “e. Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshme, jo më tej se 6 muaj”.

<sup>31</sup> Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “j. Gjykimet e çështjeve të karakterit administrativo-penal dhe i çështjeve civile pa palë kundërshtare në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 2 muaj”.

- (v) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjyqimit për 2 (dy) çështje në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale”, rezulton të jetë 75 ditë, rreth 2 muaj e 15 ditë, **pra më e gjatë se standardi minimal** për gjykimin e çështjeve të karakterit administrativo-penal në Gjykatën e Shkallës së Parë.

## KONKLUZIONE

Kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon më një pikëzim prej 4 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, tejkalohe vetëm për 15 ditë apo për 26 ditë, si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, konsiderohet më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.*

## 2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...}, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe nga 30.05.2016 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Gjithashtu nga shtatori i vitit 2016 edhe atë të kryetares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, njëkohësisht në dhomën civile e penale. Gjithashtu me vendimin nr.22, datë 22.02.2016 të KLD-së, gjyqtarja {...} është deleguar në përbërje të trupës gjykuese për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavaje, për të shqyrtuar përkatësisht 34 çështje. Ajo ka deklaruar se gjatë tre viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 843 çështje, ka përfunduar gjithsej 704 çështje për tre vjet, si dhe ka mbartur në vitin 2017 gjithsej 81 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 83,5 %. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet e Kavaje për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, gjyqtarja {...} ka përfunduar gjithsej 400 çështje gjyqësore, nga të cilat 41 penale, 59 kërkesa penale, 249 civile me palë kundërshtare dhe 51 kërkesa civile”.*

Për periudhën e vlerësimit gjyqtares {...}:

- Për vitin 2013 (08.10.2013-31.12.2013), ka përfunduar 20 çështje.
- Për vitin 2014 (01.01.2014-31.12.2014), i janë caktuar për shqyrtim 171 çështje të reja, ka përfunduar 145 çështje.
- Për vitin 2015 (01.01.2015-31.12.2015), i janë caktuar 149 çështje të reja, ka përfunduar 136 çështje.
- Për vitin 2016 (01.01.2016-08.10.2016), ka përfunduar në total 237 çështje, ku 29 çështje i ka përfunduar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet; 70 çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë (gjyqtare e deleguar), si dhe 138 çështje të gjykuar në Gjykatën e Lezhë.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 83.5% i përcaktuar në faqen 24 të Raportit.

## KONKLUZIONE

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi nuk bën vetëm një veprim matematikor për të përcaktuar rendimentin e përfundimit të çështjeve, por ai bazohet edhe në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai nivelit të përqindjes. Ky vlerësim mund të shkojë deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda vitit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës në fuqi. Në rastin konkret, rezulton se gjyqtarja {...} me vendimin nr.22, datë 22.02.2016 të KLD, është deleguar për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për 34 çështje, duke pasur kështu një rritje të papritur të volumit të çështjeve, por nga ana tjetër nuk rezulton të ketë gjykuar më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës në fuqi. Rezulton që gjyqtarja ka përfunduar në total për të gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 538 çështje, nga të cilat 437 çështje<sup>32</sup> kanë qenë çështje me palë kundërshtare, mesatarisht 146 çështje themeli në vit, nga 200 çështje (*krime, kundravajtje dhe civile me palëve kundërshtare*) të përcaktuara si standardi sasior i punës, që nënkupton realizmin nga gjyqtarja brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale, për gjyqtarin e shkallës së parë, gjykatë që nuk është e organizuar në seksione. Përveç kësaj, rendimenti 83.5% nuk është afër kufirit maksimal të kategorisë “Mbi 81-87%”, që të mundësonte pikëzimin në një shkallë më të lartë. Në këto kushte, gjyqtarja për këtë tregues vlerësohet me 4 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” vlerësohet “Mbi 81-87%”, duke e pikëzuar me 4 pikë.*

<sup>32</sup> 50 penale; 91 civile; 2 urdhër mbrojtje dhe 24 familjare.

## 2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykatat<sup>33</sup> lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja {...} i kushton shumë rëndësi arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve, pa patur vonesa dhe brenda afateve ligjore. Kështu, vendimet janë arsyetuar prej saj pas 4 ditëve (shih dosjen 1), pas 3 ditëve (shih dosjen 2), pas 5 ditëve (shih dosjen 3) dhe pas 6 ditëve (shih dosjen 5). Për dosjen e katërt, nuk pasqyrohen të dhëna lidhur me dorëzimin e vendimit”*.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Ndërsa referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me Ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10 ditë (neni 308 paragrafi 2), me përjashtim të rastit kur

---

<sup>33</sup> Informacioni i dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet nëpërmjet postës elektronike në datën 08.10.2021 dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë me shkresën nr. 1965 Prot., datë 12.10.2021.



gjkata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5 ditë. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

**- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :**

- Dosja 1, që i përket vendimit penal me nr. 49/409, datë 03.12.2015, është dorëzuar në datën 07.12.2015 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 2, që i përket vendimit civil me nr. 179/274, datë 01.12.2014 është dorëzuar në datën 04.12.2014 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 3, që i përket vendimit civil me nr. 161/239, datë 05.11.2014 është dorëzuar në datën 10.11.2014 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 4, që i përket vendimit civil me nr. 402, datë 22.07.2016 është dorëzuar në datën 05.08.2016 - (14 ditë), jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 5, që i përket vendimit civil me nr. 52 (01), datë 14.01.2013 është dorëzuar në datën 20.01.2014 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 01.10.2020, rezulton se:

- Dosja 6, që i përket vendimit civil me nr. 44, datë 08.04.2014 është dorëzuar në datën 14.04.2014 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 7, që i përket vendimit penal me nr.29, datë 05.05.2014 është dorëzuar në datën 12.05.2014 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- Dosja 8, që i përket vendimit civil me nr.93/22-2015-146, datë 29.04.2015 është dorëzuar në datën 02.05.2015 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 9, që i përket vendimit civil me nr.21/22-2015-33, datë 27.01.2015 është dorëzuar në datën 30.01.2015 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 10, që i përket vendimit civil me nr.22-2016-82 (38), datë 23.03.2016 është dorëzuar në datën 25.03.2016- (2 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- Dosja 11, që i përket vendimit civil me nr.12-2016-460/164 datë 30.03.2016 është dorëzuar në datën 04.04.2016- (5 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se për çështje të kategorisë “Civile themeli”, koha mesatare e arsyetimit është 4.2 ditë; për çështje të kategorisë “Penale krime”, koha mesatare e arsyetimit është 5.5 ditë; për çështje të kategorisë “Familjare”, koha

mesatare e arsytimit është 6.6 ditë; për çështje të kategorisë “Kërkesa civile”, koha mesatare e arsytimit është 6 ditë.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet “Më e shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE**

### **2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Në 5 çështje penale të vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 3 seanca (shih dosjen 1), me 6 seanca (shih dosjen 2), me 4 seanca (shih dosjen 3), me 7 seanca (shih dosjen 4) dhe me 3 seanca (shih dosjen 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej 23 seanca gjyqësore, nga të cilat 14 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 9 seanca joproduktive kanë qenë kërkesa e të pandehurit për mbrojtës (1 seancë), kërkesa e avokatit për t'u njohur me aktet e çështjes (1 seancë), mosparaqitja e paditësit (1 seancë), mosparaqitja e të paditurës (2 seanca), marrja e provave shkresore (1 seancë), paraqitja e të paditurës pa një mjet identifikimi (1 seancë), kërkesa e gjyqtarës për t'u zëvendësuar në gjykim, për shkak të transferimit të saj në një gjykatë tjetër (1 seancë) dhe mungesa e gjyqtarës për arsye shëndetësore (1 seancë)”.

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, të gjitha çështjet vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës (me përjashtim të dosjes nr. 5, që i takon kategorisë kërkesë civile pa palë kundërshtare).

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 1 – që i përket çështjes penale, me nr. 58/58345-00106-22 regjistri, datë regjistrimi 06.11.2015, përfunduar me vendimin nr.49/409, datë 03.12.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproduktive. Të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale, për të njoftuar mbrojtësin e caktuar kryesisht për të pandehurin, për t'i lënë kohë mbrojtësit të caktuar për tu njohur me aktet e fashikullit penale, për të paraqitur konkluzione përfundimtare me shkrim.
- Dosja 2 – që i përket çështjes civile, me nr. 53/21001-00122-22 regjistri, datë regjistrimi 18.06.2014, përfunduar me vendimin nr.179/22-2014-274, datë 01.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka qenë joproduktive, për të njoftuar palën e paditur.
- Dosja 3 – që i përket çështjes civile, me nr.190/11300-00197 regjistri, datë regjistrimi 16.09.2014, përfunduar me vendimin nr.161/22-2014-239, datë 05.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore. Nuk ka seanca joproduktive.
- Dosja 4 – që i përket çështjes civile, me nr.21001-01118-12-2015/543/271 regjistri, datë regjistrimi 07.09.2015, përfunduar me vendimin nr.402, datë 22.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka qenë joproduktive, nuk është zhvilluar për shkak të kërkesës së gjyqtarës për t'u zëvendësuar në gjykim, për shkak të transferimit të saj në një gjykatë tjetër.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- Dosja 6 – që i përket çështjes civile, me nr. 39 regjistri, datë regjistrimi 03.01.2014, përfunduar me vendimin nr.44, datë 08.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka rezultuar joproduktive, për mosparaqitjen e palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit.
- Dosja 7 – që i përket çështjes penale, me nr.22 regjistri, datë regjistrimi 16.01.2014, përfunduar me vendimin nr. 29, datë 05.05.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 11 (njëmbëdhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 2 seanca kanë qenë joproduktive. Të gjitha seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale, të tilla si: për njoftimin e mbrojtësit të caktuar kryesisht për të pandehurin, për njoftimin e dëshmitarëve, për lënien kohë palëve për të paraqitur diskutimet përfundimtare me shkrim.
- Dosja 8 – që i përket çështjes civile, me nr. 257 (21001-00286-22-2014) regjistri, datë regjistrimi 25.11.2014, përfunduar me vendimin nr.93/22-2015-146, datë 29.04.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka qenë joproduktive, pasi është shtyrë për mosrealizimin e vlerësimit psikologjik nga ana e ekspertës.

- Dosja 9 – që i përket çështjes civile, me nr.154/21387-00155-22-2014 regjistri, datë regjistrimi 21.07.2014, përfunduar me vendimin nr.21/22-2015-33, datë 27.01.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 13 (trembëdhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 6 (gjashtë) kanë qenë joproductive, pasi janë shtyrë për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të palës paditëse, mosparaqitjen e ekspertëve, mosformim të trupit gjykues. Seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimi i ekspertëve të caktuar nga gjykata, lënien kohë palës së paditur për t’u njohur me aktin e ekspertimit, paraqitjen e provave të reja në dobi të gjykimit, për të përgatitur pretendimet përfundimtare me shkrim.
- Dosja 10 – që i përket çështjes civile, me nr. 21282-00044-22-2016 regjistri, datë regjistrimi 01.03.2016, përfunduar me vendimin nr.22-2016-82 (38), datë 23.03.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 (një) seancë ka qenë joproductive, për shkak të mosmarrjes dijeni rregullisht për seancën nga personi i tretë.
- Dosja 11 – që i përket çështjes civile, me nr.21236-00019-12-2016 regjistri, datë regjistrimi 07.01.2016, përfunduar me vendimin nr. 12-2016-460/164, datë 30.03.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, përsa kohë ka përfunduar edhe me dhënien e vendimit përfundimtar.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli dhe civile themeli) varion nga 1 deri në 13 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 4.6 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile themeli dhe penale themeli) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile dhe nenin 333 e vijues dhe 342 të K.Pr.Penale). Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Përgjithësisht, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: njoftimi i mbrojtësit të caktuar kryesisht për të pandehurin, lënien kohë mbrojtësit të caktuar për t’u njohur me aktet e fashikullit penal, njoftimi i dëshmitarëve, njoftimi i ekspertëve të caktuar nga gjykata, lënia kohë palëve për t’u njohur me aktin e ekspertimit, paraqitja e provave të reja në dobi të gjykimit, për të përgatitur pretendimet përfundimtare me shkrim, etj. Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, përgjithësisht konstatohet respektimi në çdo rast i afatit të arsyeshëm, përgjithësisht më i shkurtër se 15 ditë, për caktimin e seancave.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 10 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 4.6 seanca, por rezulton që gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

## KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri i seancave gjyqësore është më i madh se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## 2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshëm dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Në 4 çështje civile të vëzhguara, ajo ka kryer gjithnjë veprimet përgatitore (shih dosjet 2, 3, 4 dhe 5). Në këto 4 raste, veprimet përgatitore kanë qenë efektive, i kanë shërbyer ecurisë pa vonesa të gjykimit dhe janë dokumentuar gjithmonë me procesverbal, të rregullt nga pikëpamja formale..... Në çeljen e seancave gjyqësore nuk është respektuar saktësisht orari i planifikuar, ku në disa raste seanca është çelur përpara orarit, ndërsa në disa raste është çelur pas orës se planifikuar. Megjithatë, ky fakt nuk ka sjellë dështimin e seancës në ndonjë rasti. Në planifikimin e seancave gjyqësore, gjyqtarja është treguar e kujdesshme, duke respektuar afatet ligjore, me përjashtim të 1 rasti, ku seanca e parë gjyqësore është caktuar përpara 10 ditëve, duke mos respektuar nenin 333 pika 2 të K.Pr.Penale (shih dosjen 1).....Gjatë gjykimit, ajo identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, tek pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimi përfundimtar gjer tek shpallja e vendimit. Një tipar i mirë i punës së saj është zhvillimi i seancave në sallë gjykimi, duke i dokumentuar audio në funksion të transparencës dhe të solemnitetit.....Në shumicën e rasteve është konstatuar se në procesverbal nuk është dokumentuar shkaku i vonesës së çeljes së seancës gjyqësore, megjithëse vonesa nuk ka qenë e vogël, por i vetmi rast që është e dokumentuar vonesa është dosja 1, ku në procesverbalin e

*seancës gjyqësore penale të datës 02.02.2015, lidhur me vonesën 53 minuta, është pasqyruar si shkak “mungesa e sallave të lira”.*

**- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :**

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare dhe 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave civile pa palë kundërshtare. Gjyqtarja në përgjithësi i ka vënë në lëvizje çështjet, duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore në çështjet civile dhe caktimin e seancës gjyqësore në çështjet penale, në çdo rast, duke filluar që nga brenda ditës, deri në 8 ditë pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave të gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Seancat përgatitore dhe ato gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara përgjithësisht janë dokumentuar në procesverbalin e seancës, duke u mbajtur me sistemin e regjistrimit audio, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Me përjashtim të dy prej çështjeve, në të cilat seancat përgatitore dhe ato gjyqësore janë dokumentuar në procesverbalin e mbajtur me dorëshkrim nga sekretarja gjyqësore, kjo për faktin se sistemi i regjistrimit audio në këtë gjykatë ka filluar të funksionojë pas regjistrimit të këtyre çështjeve në gjykatë.

*Në çështjet civile:* Përgjithësisht, rezulton që seancat gjyqësore të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre, relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni nga palët që nuk janë paraqitur, disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura, shpalljen e trupit gjykues, dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake, disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla, deklarin të hapur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave, administrimin e provave, drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat, si dhe mbi elementët proceduralë të zhvillimit të gjykimit, dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat, deklarin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

*Në çështjen penale:* Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal të themelit, duke respektuar parashikimet ligjore procedurale për gjykimin e zakonshëm, apo gjykimin e shkurtuar. Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për të relatuar verifikimin e paraqitjes së palëve e të mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm apo gjykim i shkurtuar), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, si dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa nga 2 deri në 15 minuta, që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjyqimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë, konstatohet se një numër i konsiderueshëm seancash të filluara me më shumë se 20 minuta me vonesë, deri në 1 orë 15 minuta me vonesë, nga ora e planifikuar. Në dy raste, fillimi me 29 minuta apo 60 minuta vonesë ka sjellë joproduktivitetin e zhvillimit të seancave gjyqësore, për shkak se pala (përfaqësuesi i palës paditëse apo ekspertët) nuk kanë qenë prezent. Shkaku i vonesës në zhvillimin e seancës gjyqësore, në rastet kur ai është relatuar nga gjyqtarja, lidhet me pjesëmarrjen e saj në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, apo mospasja e sallave të lira për gjykim.

## **KONKLUZIONE**

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtarja në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Numri i konsiderueshëm i seancave të filluara me vonesë në këtë rast, si dhe shtrirja kohore e vonesës, pavarësisht relatimit ose jo të shkakut për palët prezent, është një e dhënë që në këtë rast nuk tregon shkallë shumë të lartë aftësie të gjyqtarës, në drejtim të planifikimit dhe mbikëqyrjes së fillimit në kohë të seancave gjyqësore. Nga ana tjetër, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjyqimit civil dhe penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi : Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 16 pikë.*

## **2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE**

### **2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile (shih dosjet nr. 2, 3, 4 dhe 5) ose penale (shih dosjen nr.1 ). Në çdo dosje të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Të gjitha procesverbalet, të seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje, rezulton se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, gjithashtu të nënshkuara nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtari, konform kërkesave të nenit 118 të K.Pr.Civile dhe 345 të K.Pr.Penale. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë.....Dosjet 2, 3 dhe 4 nuk janë të inventarizuara rregullisht, pasi nuk janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim janë vendosur vendimi i gjyqtarës {...} për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore e me pas procesverbalet e seancave përgatitore të pajtimit. Po kështu konstatohet parregullsi, se në këtë dosje ndodhet e administruar një tjetër kërkesë padi, që nuk ka lidhje me çështjen objekt gjykimi (shih dosjen 2); është administruar vendimi i gjyqtarës për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore i datës 08.10.2014, përpara procesverbalit të seancës përgatitore të datës 26.09.2014 (shih dosjen 3); janë administruar bisedimet përfundimtare të paditësit, seanca gjyqësore e datës 22.07.2016 e vendimi përfundimtar dhe me pas vlerësimi psikologjik i fëmijës, njoftimet e palëve dhe seancat e tjera gjyqësore nga data 01.04.2016 e në vazhdim. Në fund të dosjes janë administruar aktet e çështjes për veprime gjyqësore të kryera nga gjyqtari Luan Lusha, duke pasqyruar mungesë të kronologjisë në renditjen e akteve (shih dosjen 4). Në dosjen 1 dhe 5 aktet janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale penale e civile dhe të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht e shfrytëzueshme për palët”.

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori.

Renditja e akteve në çështjet penale fillon me aktin e shortit, vijon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Renditja e akteve në çështjet civile fillon me aktin e shortit, vijon me padinë dhe provat e paraqitura nga palët, vendimin e gjyqtarës për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet e seancave përgatitore, vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykata më e lartë.



Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

## **KONKLUZIONE**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

## **2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “*Dosjet 2, 3 dhe 4 nuk janë të inventarizuara rregullisht, pasi nuk janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim janë vendosur vendimi i gjyqtares {...} për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore e me pas procesverbalet e seancave përgatitore të pajtimit. Po kështu konstatohet parregullsi, se në këtë dosje ndodhet e administruar një tjetër kërkesë padi, që nuk ka lidhje me çështjen objekt gjykimi (shih dosjen 2); është administruar vendimi i gjyqtares për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore i datës 08.10.2014, përpara procesverbalit të seancës përgatitore të datës 26.09.2014 (shih dosjen 3); janë administruar bisedimet përfundimtare të paditësit, seanca gjyqësore e datës 22.07.2016 e vendimi përfundimtar dhe me pas vlerësimi psikologjik i fëmijës, njoftimet e palëve dhe seancat e tjera gjyqësore nga data 01.04.2016 e në vazhdim. Në fund të dosjes janë administruar aktet e çështjes për veprime gjyqësore të kryera nga gjyqtari Luan Lusha, duke pasqyruar mungesë të kronologjisë në renditjen e akteve (shih dosjen 4). Në dosjen 1 dhe 5 aktet janë sistemuar në mënyrë kronologjike në referencë të rregullave procedurale penale e civile dhe të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht e shfrytëzueshme për palët”.*

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga

grykataka (njoftimet për çdo seane, prosesverbalet e çdo seane përgatitore apo gryqësore, vendimet gryqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (padi, provat, prapësimet, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete, me përjashtim të dosjes nr. 2, ku në aktet e dosjes ndodhet e administruar një tjetër kërkesëpadi, që nuk ka lidhje me çështjen objekt grykimi.<sup>34</sup>

## KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gryqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gryqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gryqtares në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gryqtares”

KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GRYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	90

## 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gryqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gryqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.*

### 3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i

<sup>34</sup> Në faqen 29-31 të dosjes gryqësore, apo në faqet 426 -428 të dosjes së rivlerësimit.

*procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtares {...}. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt”.*

### **3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.1289/4 Port., datë 25.06.2018 rezulton se 1 (një) ankesë e vitit 2014 është verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, lidhur me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi etik dhe profesional. Në lidhje me këtë ankesë rezulton se:

Shtetasit S.B. dhe H.B. kanë bërë ankesë pranë KLD në vitin 2014 ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtares {...}, për shkelje formale të ligjit, në lidhje me çështjen penale me të pandehur F.P, i akuzuar për “Mjekim të pakujdesshëm”. Për verifikimin e ankesës është urdhëruar me urdhrin nr. 1395/2 Prot., datë 20.05.2014.

Në datën 20.03.2018 inspektorët e KLD pasi kanë verifikuar ankesën dhe dokumentacionin përkatës kanë konkluduar se : *“Gjykimi ka zgjatur 8 muaj e 10 ditë, llogaritur nga data e shorit, 30.07.2013 deri në datën e dhënies së vendimit, 10.04.2014. Kjo kohëzgjatje është konstatuar se është brenda afatit të parashikuar në pikën 5 gërma “a” e ankesit nr.1 për “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së. Lidhur me pretendimin se vendimi është zbardhur tej afati, sipas regjistrit të dorëzimit të vendimeve, ka rezultuar se vendimi penal nr. 23, datë 10.04.2014 është dorëzuar i arsyetuar në sekretari në datën 16.04.2014 dhe dosja e plotë është dorëzuar në datën 20.04.2014. Pra vendimi është dorëzuar me një ditë vonesë, në referim të nenit 113 të K.Pr.Penale, ku parashikohet: “Origjinalet e akteve të gjykatës depozitohen në sekretari brenda 5 ditëve nga bërja e tyre”. (i) Në lidhje me pakënaqësinë e ankuesve për vendimmarrjen e gjyqtares {...}, rezulton se me vendimin 163/572, datë 17.07.2014 të Gjykatës së Apelit Gjjirokastër, është vendosur “Lënien në fuqi të vendimit penal nr.23, datë 10.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet sa i përket fajësisë, cilësimit juridikë të veprës penale, dënimin kryesor dhe shpenzimet gjyqësore. Ndryshimin e vendimit për pjesën tjetër si më poshtë: - Mosaplikimin e nenit 59 të K.Penal...”. Ky vendim është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2015-1084, datë 27.05.2015”. Shkelja e pretenduar në lidhje me këtë vendimmarrje është në lidhje me aplikimin e nenit 59 të K.Penal, e shoqëruar edhe me vonesën në dorëzimin e vendimit të arsyetuar me një ditë... Në këtë rast shkelja e pretenduar në lidhje me vendimmarrjen ka të bëjë me aplikimin e dispozitës materiale, për rrjedhojë nuk përben shkelje disiplinore në vështrim të*

nenit 32 pika 2 shkronja "c" të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizmin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". (ii) Në lidhje me shkeljen e pretenduar për vonesën në arsyetimin e vendimit, rezulton se nga ana formale ka shkelje, pasi është në tejkallim të afatit të parashikuar nga neni 133 i K.Pr.Penale....Nga përmbajtja e vendimeve të Gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë nuk rezulton se vonesa me 1 ditë e arsyetimit të vendimit të ketë cenuar apo vënë në vështirësi palët për ushtrimin e të drejtës kushtetuese në lidhje me procesin e rregullt ligjor (e drejta e ankimit). Arkivimin e ankesës së shtetasve H.B. e S.B. ndaj gjyqtarës {...}, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, për shkelje formale të ligjit në gjykimin e çështjes penale të gjykuar me vendimin nr. 23, datë 10.04.2014, për shkak se shkelja nuk është thelbësisht e tillë që të mund të iniciohet një procedim disiplinor, duke u bërë relacioni pjesë përbërëse e dosjes së vlerësimit dhe e përdorshme vetëm në rastin e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarit". Relacioni i sipërcituar është miratuar nga Kryeinspektorja e KLD në datën 16.12.2014.

Referuar akteve të dosjes së rivlerësimit, si dhe dosjes personale të gjyqtarës {...}, nuk rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, të jetë dhënë apo zbatuar masë disiplinore ndaj saj.

Në relacionin e hartuar nga Inspektorati i KLD nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që të dëshmojnë shfaqje e sjellje që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbajtjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo prania e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarës.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 117, datë 21.03.2019, rezulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarës, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit profesional, janë gjetur të pabazuara.

## **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin "Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion" vlerësohet "Shumë e lartë", duke e pikëzuar me 35 pikë.

## **3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se "Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtë".

### 3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
  - “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
  - Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
  - Të dhënat për masa disiplinore;
  - Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj gjyqtarës {...}, në periudhën e vlerësimit, të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur gjithsej 2 (dy) ankesa në Inspektoratin e ish KLD. Një ankesë e vitit 2016 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet kanë qenë të pabazuara dhe ankesa tjetër e paraqitur në vitin 2014, është referuar dhe analizuar në treguesin e analizuar më sipër. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarës, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se “Për sa më sipër, nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, vërehet se nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit, ato rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin”.<sup>35</sup>

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 117, datë 21.03.2019, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarës, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara duke konkluduar se: “Nga hetimi administrativ nuk u gjetën element që të

---

<sup>35</sup> Faqe 12 e vendimit të KPK nr. 117, datë 21.03.2019.

*vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara nga nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës”<sup>36</sup>.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës.

## **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.*

## **3.C PAANËSIA E GJYQTARES**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të venë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasoje cenimin e parimit të gjykatës së paanshme”.

### **3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përsheptuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;

<sup>36</sup> Faqe 12 e vendimit të KPK nr. 117, datë 21.03.2019.

- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtares.

### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### **3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtares dhe as kërkesa të vetë gjyqtares për heqjen dore nga gjykimi i çështjes...”.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtares, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares në periudhën e vlerësimit. Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares” vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### ***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”***

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

#### **4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares {...} në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### **4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT**



Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qofte në seancat përgatitore, qofte në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e saj”*.

#### **4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

#### **KONKLUZIONE**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

#### **4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

*Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “I lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit {...} për të bashkëpunuar me koleget dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale ta. Në 8 raste, subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtare e vetme për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore, për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale civile e penale”.

#### **4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkallë të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...}, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 27 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 47 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të shkallës së parë, në*

*një gjykatë të paorganizuar në seksione. Këto të dhëna tregojnë gatishmërinë e saj të lartë për t' u angazhuar në aktivitete profesionale”.*

#### **4.C.A. Pjesëmarrja e GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDEUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.1289/4 Prot., datë 25.06.2018, vërtetimit me nr. 801 Prot., datë 21.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ajo ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësues dhe pjesëmarrëses. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Në cilësinë e lehtësueses në Programin e Formimit Vazhdues në 2 (dy) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 4 ditë trajnimi;
- (ii) Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 25 (nëntë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 43 ditë trajnimi.

Duke iu referuar nenit 55, pika 9<sup>37</sup> të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e ekspertit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues, duke u përlllogaritur 1 ditë pjesëmarrje si ekspert e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës trevjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 51 ditë në të gjithë periudhën e vlerësimit.

---

<sup>37</sup> Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se :”Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

*Ky kontribut vlen vetëm për përlllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.*

Për periudhën e vlerësimit nuk rezultojnë që gjyqtarja të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 27 aktivitete të zhvilluara për 51 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

*Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, vlerësohet nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

#### **4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përsheptuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtares, rezultojnë se gjyqtarja është angazhuar në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuese në 2 (dy) aktivitete trajnuese brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses në dy aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese.

*Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

#### **4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përshpejtuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, formularit të deklaramentit për aftësitë profesionale të gjyqtares, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtarja së bashku me kundërshtimet lidhur me këtë tregues, rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013-2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë, pjesëmarrje në konferenca shkencore dhe dhënie kontributi për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit.

- Konkretisht, gjyqtarja ka marrë pjesë në takimet e grupit të punës pranë Kuvendit të Shqipërisë të zhvilluara në datat 29.06.2015-03.07.2015, lidhur me hartimin e dokumentit me gjetjet dhe problematikat në drejtësinë penale dhe hartimin e disa prej dispozitave të K.Pr.Penale në kuadër të procesit të Reformës në Drejtësi.
- Në datat 26 – 29 Maj 2016 ka marrë pjesë në Konferencën e 13-të Bienale të Shoqatës Ndërkombëtare të grave gjyqtare me temë “Gratë gjyqtare dhe rendi ligjor”, organizuar nga NAWJ USA në Washington, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjithashtu nga ky aktivitet në maj 2016 e në vazhdim ka qenë anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare të grave gjyqtare IAWJ.
- Në datat 17-18 tetor 2016, ka marrë pjesë në Konferencën nacionale për shënimin e Javës për të drejtat e viktimave të krimit, në Prishtinë, në Kosovë si dhe në vijim në takimet me koordinatorët për mbrojtjen e viktimave pranë Prokurorive në Shqipëri.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.*

#### **4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësisë profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- “Akti i Vlerësimit të Përsheptuar” për periudhën janar-dhjetor 2014, miratuar me vendimin nr. 69/3, datë 19.06.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nga aktet e dorëzuara nga gjyqtarja bashkëlidhur formularit të vetëvlerësimit profesional, evidentohet se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja ka realizuar dy publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës, si më poshtë:

- Shkrimi me titull “Shpronësimi. Problematika gjyqësore që ekziston në këtë drejtim”, botuar në Revistën juridike shkencore “Jeta Jurdike”, e Shkollës së Magjistraturës, qershor 2015;
- Shkrimi me titull “Eutanazia dhe problematika që lidhet me përgjegjësinë penale”, botuar në Editorialin “Avokatia 17”, e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, janar 2016.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtaren {...} ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

#### **KONKLUZIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për rrjedhojë, ky tregues pikëzohet me 5 pikë.

*Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” rezulton angazhimi i gjyqtares, prandaj gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.*

#### ***Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”***

<b>KRITERI</b>	
<b>AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>	
<b>Niveli i vlerësimit</b>	<b>Pikët</b>
Shkëlqyeshëm	100



**NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

<b>Niveli i vlerësimit për çdo kriter</b>		
<b>Kriteri</b>	<b>Pikët</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	90	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	100	Shkëlqyeshëm
<b>Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit</b>		
Vlerësimi i përgjithshëm	390	Shkëlqyeshëm

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**